

VENDIM
Nr. 437, datë 22.6.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM
LETRASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN PËR REAGIMIN NDAJ EMERGJENCËS COVID-19
NË SHQIPËRI, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 144/2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për reagimin ndaj emergjencës COVID-19 në Shqipëri, ratifikuar me ligjin nr. 144/2020, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani
Perëndimor Evropë dhe
Rajoni i Azisë Qendrore

WORLD BANK GROUP OFFICE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

2 qershor 2022

E nderuar znj. Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Nr. 3, 1001, Tiranë
Shqipëri

E nderuar zonja Ministre,

Shqipëria: Projekti i reagimit ndaj emergjencës COVID-19 (huaja nr. 9160-AL) zgjatja e datës së mbylljes dhe rishikimi i treguesve të rezultateve

I referohemi Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), të datës 15 tetor 2020.

Ne gjithashtu i referohemi edhe shkresave: i. nga Ministria e Financave, të datës 9 maj 2022, duke kërkuar nga Banka zgjatjen e datës së mbylljes së huas; dhe ii. nga Ministria e Shëndetësisë

dhe Mbrojtjes Sociale, të datës 23 maj 2022, duke i kërkuar Bankës rishikimin e treguesve të rezultateve.

Sa më sipër, kam kënaqësinë të pajtohem me kërkesat tuaja. Në këtë mënyrë, Banka ka vendosur datën 31 dhjetor 2022, si datë të mëvonshme për qëllimet e seksionit III.B.2, të skedulit 2, të Marrëveshjes së Huas.

Për më tepër, treguesit e rezultateve zëvendësohen me tekstin, siç parashikohet në shtojcën I të kësaj shkrese.

Me respekt,
LINDA VAN GELDER
Drejtoresha Rajonale, Ballkani Perëndimor
Evropa dhe Rajoni i Azisë Qendrore

Për dijeni: e nderuara znj. Ogerta Manastirliu, Ministre, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Znj. Mira Rakacolli, Zëvendësministre, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë;

Znj. Erjona Hoxhaj, Shefe e Kabinetit dhe Koordinatorë e Përgjithshme e projektit të HSIP-së, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Znj. Mejvis Kola, Drejtore e Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve dhe Licencave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Znj. Blerina Dudushi, Menaxhere e projektit PCU HSIP, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Z. Matteo Bugamelli, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore.





